



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
MINISTRI

Nr. G-132/Prot.
2

Tiranë, më 24/10/2022

URDHËR

Nr. 578, Datë 24.10.2022

**“PËR
HEQJEN E LICENCËS SË USHTRIMIT TË PROFESIONIT TË NOTERIT, NOTERIT
GAZMIR BEGAJ”**

Në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, të nenit 7 pikës 2 të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja “a”, dhe nenit 67 të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, nisur nga administrimi i kërkesës së noterit Gazmir Begaj për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, administruar pranë Ministrisë së Drejtësisë me nr. G-132 prot., datë 10.10.2022,

KONSTATOJ:

Përmes shkresës së administruar nga Ministria e Drejtësisë me nr. G-132 prot., datë 10.10.2022, noteri Gazmir Begaj, i cili ka fituar të drejtën e ushtrimit të profesionit të noterit bazuar në Lejen nr. 4436/1 datë 22.06.2005 të Ministrit të Drejtësisë “Për ushtrimin e profesionit të noterit”, ka paraqitur kërkesën për heqje dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit.

Ligji Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar, në nenin 21, gërma “a”, parashikon heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit përmes Urdhrit të Ministrit të Drejtësisë, kur noteri heq dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, me kërkesën e tij.

Sipas nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për Noterinë”, i ndryshuar dhe konkretisht pikës 1 dhe 2 të tij, në rast të mbylljes së përkohshme ose të përhershme të një zyre noteriale, arkivi i noterit në largim merret nga noteri që plotëson vendin vakant. Nëse një vend vakant mbetet i paplotësuar, dega vendore përkatëse e Dhomës përzgjedh një tjetër noter në atë bashki për të marrë përsipër arkivin, në bazë të përzgjedhjes me short. Dega vendore përkatëse mund të zgjedhë një noter të propozuar nga noteri në largim. Në çdo rast, noteri i zgjedhur ka për detyrë të marrë përsipër arkivin.

Sa më sipër, nisur nga administrimi i kërkesës së noterit Gazmir Begaj, për heqjen dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit, si dhe në respektim të parashikimeve të akteve ligjore e nënligjore në fuqi për noterinë, dhe në mbështetje të nenit 102, pikës 4, të Kushtetutës, të nenit 6, nenit 7 pikës 2, të Ligjit Nr. 8678, datë 14.05.2001, “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, i

ndryshuar, të nenit 21, pika 1, shkronja “a”, dhe nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Heqjen e licencës së ushtrimit të profesionit të noterit Gazmir Begaj, anëtar i Degës Vendore të Noterisë Vlorë, për shkak të heqjes dorë nga ushtrimi i profesionit të noterit.
2. Ngritjen e Komisionit të Dorëzimit të Arkivit të përbërë nga anëtarët e mëposhtëm:
 - a) Znj. Erisa Sulçe, Specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - b) Znj. Hyri Ramaj, Specialiste pranë Ministrisë së Drejtësisë;
 - c) Një noter i caktuar nga Dega Vendore e Noterisë Vlorë;
 - d) Një noter i caktuar nga Dhoma e Kombëtare e Noterisë.
3. Nxjerrjen jashtë përdorimi të vulave respektive, vulës së thatë dhe vulës së njomë, të noterit Gazmir Begaj, nga Komisioni i caktuar në pikën 2, të këtij urdhri.
4. Të njoftohen menjëherë me përmbajtjen e këtij Urdhri institucionet e linjës, Dhoma Kombëtare e Noterisë, gjykatat e shkallës së parë dhe apelit, Gjykata e Lartë, Gjykata Kushtetuese, Prokuroria e Përgjithshme, Struktura e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, Gjykata e Posaçme e Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Gjykata e Posaçme e Apelit për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, Drejtoria e Përgjithshme e Parandalimit të Pastrimit të Parave, Bankat e nivelit të dytë.
5. Gjatë marrjes në dorëzim të arkivit, Komisioni i Dorëzimit të Arkivit të verifikojë përputhshmërinë e të gjithë dokumentacionit dhe akteve noteriale që përmban arkiva me veprimet e reflektuara në regjistrat noterialë, si dhe të evidentojë çdo mungesë dhe çdo dëmtim të dokumenteve arkivorë, nëse ka të tilla.
6. Dega Vendore e Noterisë Vlorë dhe Dhoma Kombëtare e Noterisë, brenda 7 ditëve nga marrja dijeni e këtij Urdhri, të përcjellë emrin e noterit për marrjen në dorëzim të arkivit, në përputhje me kërkesat e nenit 67, të Ligjit Nr. 110/2018 “Për noterinë”, i ndryshuar.
7. Komisioni i Dorëzimit të Arkivit, pas administrimit të emrit të noterit, sipas pikës 6, të këtij Urdhri, merr masa për dorëzimin me procesverbal të arkivës noterit të përcaktuar nga Dega Vendore përkatëse e Noterisë.
8. Ky urdhër, së bashku me të dhënat përkatëse, të regjistrohen në Regjistrin e Noterëve në Ministrinë e Drejtësisë dhe Dhomës Kombëtare të Noterisë.
10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë pranë Ministrisë së Drejtësisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, Dega Vendore e Noterisë Vlorë, të marrin masat e nevojshme për zbatimin e këtij Urdhri.

11. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Çështjeve Rregullatore të Drejtësisë për njoftimin e këtij Urdhri noterit Gazmir Begaj, Dhomës Kombëtare të Noterisë dhe Degës Vendore të Noterisë Vlorë.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI

Ulsi Manja

